




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr.485/2022
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e 300-të, të mbajtur me 14 dhjetor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anëtarë për të shërbyer në panelin hetimor për lëndën Nr.AD/KGJK/21/2022/GJS-GJS-2022-019, caktohen gjyqtarët:
- Faton Ademi, gjyqtar, Gjykata e Apelit, kryesues;
 - Mevlide Kosumi Qarri, gjyqtare, Gjykata Themelore në Prishtinë, anëtar;
 - Lulzim Paçarrizi, gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, anëtare;

 - Lindita Berisha, gjyqtare, Gjykata Themelore në Prishtinë, anëtare rezervë;
 - Ilir Rashkaj, gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjakovë, anëtar rezervë;
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 14 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 14 dhjetor 2022, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, sipas nenit 11 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve, që janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që do të hetohet.

Paneli hetimor zhvillon hetimin bazuar në nenin 12 paragrafi 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethanat të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit, Këshilli mundë t'i zgjasë mandatin panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të panelit hetimor;

